

E DREJTA PËR TË VOTUAR PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

MONITORIMI I

ZGJEDHJEVE

PARLAMENTARE 2020



Botues: Shoqata „Inkluziva“ - Kumanovë

Për botuesin: Bllagica Dimitrovska, Prezidente

Autorë: Bllagica Dimitrovska, Tatjana Arsovska

Përkthim: Arben Imeri

Grafika: KOMA

Viti i botimit: 2021

E zhvilluar me mbështetje nga Fondacioni Uestminster për Demokraci përmes Nismës për demokraci në Ballkanin Perëndimor.

Shkup, janar 2021

Përgatitja e kësaj analize mbështetet nga Nisma për demokraci në Ballkanin Perëndimor, një program i Fondacionit Uestminster për demokraci. Përmbajtja e kësaj analize nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet ose mendimet e Fondacionit Uestminster për demokraci ose të Qeverisë Britanike.

LISTA E SHKURTESAVE

BE	Bashkimi Evropian
KDPA	Konventa e Kombeve të bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
OBESH	Organizata botërore e shëndetësisë
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
KSHZ	Komisioni shtetëror i zgjedhjeve
KKZ	Komisionet komunale të zgjedhjeve
BZ	Bordi zgjedhor
NJZ	Njësia zgjedhore

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	3
Parathënie	6
1. Hyrje	8
2. Për projektin	10
3. Historiku	11
4. Përmbledhje e vëzhgimit të zgjedhjeve 2020	16
5. Vëzhgim i zgjedhjeve	19
6. Rezultatet e vëzhgimit të votimit	24
A. Qasshmëria në objekte dhe ambiente	26
B. Qasshmëria në procesin e votimit	39
C. Masat për të mbrojtur nga përhapja e KOVID-19	49
Ç. Parregullsi të tjera në procesin zgjedhor	52

7. Konkluzione nga vëzhgimi i votimit	54
8. Informacion mbi zgjedhjet dhe fushatat parazgjedhore	56
9. Analizë nga monitorimi i raportimit të mediave gjatë fushatave parazgjedhore 2020	63
A. Lajmet qendrore	68
B. Emisione me debate politike	72
C. Dita e zgjedhjeve	75
10. Rekomandime	77

PARATHËNIE

Analiza nga vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare në vitin 2020 në Republikën e Maqedonisë së Veriut është rezultat i numrit më të madh të misioneve vëzhguese të përbërë ndonjëherë nga persona me aftësi të kufizuara si vëzhgues. Ky është vëzhgimi i parë i tillë i zgjedhjeve parlamentare, por edhe në rrethana të një pandemie globale. Kjo analizë shërben për të kujtuar institucionet se e drejta e votës për qytetarët me aftësi të kufizuara në vend, për fat të keq, ende nuk është e garantuar. Personat me aftësi të kufizuara, megjithëse janë një grup i madh i popullsisë, janë pothuajse të padukshëm dhe pak të përfaqësuar në ligjërimin mediatik si dhe informacionin gjatë zgjedhjeve. Votuesit me aftësi të kufizuara përballen me qendra të paarritshme votimi dhe kufizime në ushtrimin e të drejtës së tyre të votës. Megjithëse janë ndërmarrë hapa në formën e ndihmëseve për votim të pavarur, hapësira për përmirësim mbetet ende e madhe. Së fundmi, qytetarët me aftësi të kufizuara rrallë mund të njohin nevojat e tyre dhe të gjejnë kandidatë që vetë janë persona me aftësi të kufizuara në listat e kandidatëve të partive politike.

Për këto arsye, ne jemi të nderuar që ishim në gjendje të kontribuojmë në rritjen e dukshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor. Është një lumturi e veçantë të dëgjohen mendimet e vetë vëzhguesve, për të cilët kjo ishte një përvojë edukative, por edhe një mundësi për angazhim qytetar në proceset demokratike. Një nga vëzhguesit tha se ishte i inkurajuar që anëtarët e bordeve zgjedhore mund të njohin personat me aftësi të kufizuara jo vetëm si votues por edhe si vëzhgues të këtij procesi. Shpresojmë që personat me aftësi të kufizuara të vazhdojnë të marrin pjesë në vëzhgimin e zgjedhjeve.

Qëllimi i këtij raporti është të ndihmojë institucionet, veçanërisht ato që janë përgjegjëse për procesin zgjedhor, për të parë sfidat praktike me të cilat përballen këta qytetarë dhe për të punuar në drejtim të mënjanimin të pengesave. Partitë politike, të cilat tregojnë përmirësime në qashtësinë në ciklet e fundit zgjedhore, për të vazhduar edhe më intensivisht me përmirësimin

e aksesit të tyre, por edhe me përfshirjen e qytetarëve me aftësi të kufizuara në punën e tyre, anëtarësimin dhe organet, si dhe në listat e tyre të kandidatëve. Pa praninë e personave me aftësi të kufizuara në institucionet përfaqësuese, vihet në dyshim përfaqësimi i tyre për të gjithë qytetarët.

Ne do të dëshironim të falënderonim Fondacionin Uestminster për Demokraci për mbështetjen e këtij vëzhgimi përmes Nismës për demokracisë në Ballkanin Perëndimor të mbështetur nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe përpjekjeve të tyre për njerëzit me aftësi të kufizuara në vend. Ne falënderojmë anëtarët e tjerë të Inkluziva që mbështetën tërë këtë proces. Faleminderit Marija Basheska për interpretimin dhe mbështetjen në gjuhën e shenjave. Së fundmi, falë të gjithë vëzhguesve të këtyre zgjedhjeve parlamentare, pa punën e të cilëve kjo përpjekje nuk do të ishte e mundur dhe ne i urojmë atyre shumë suksese dhe angazhim qytetar.

1. HYRJE

Personat me aftësi të kufizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm RMV) përballen me një nivel të ulët të pjesëmarrjes në proceset politike dhe të vendimmarrjes. Ky fenomen është pasojë e praktikës shumëvjeçare të qasjes mjekësore ndaj aftësisë së kufizuar, sipas së cilës, personat me aftësi të kufizuara shihen si objekte për bamirësi dhe trajtim në vend të qytetarëve me të drejta të barabarta politike dhe elektorale.

Sipas hulumtimit të OSBE-së¹ nga viti 2017, 27% e të anketuarve nga partitë politike besojnë se personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë në jetën politike dhe publike. Në sondazhin e Inkluziva nga 2016, vetëm 1% e të anketuarve me aftësi të kufizuara raportuan pjesëmarrje në jetën politike. Sipas këtyre të dhënave, personat me aftësi të kufizuara nuk janë përfshirë sa duhet në procesin politik, ndërsa politika merret me to dhe miratohen masa dhe politika që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre, pavarësisht nëse janë të përfshirë apo jo.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme që personat me aftësi të kufizuara të dinë se ata kanë të drejtë dhe se duhet të marrin pjesë në proceset politike dhe vendimmarrëse, sepse vetëm atëherë ata do të jenë në gjendje të shprehin nevojat e tyre dhe të sugjerojnë mënyra për t'i përmbushur ato nevoja.

Çështja e pjesëmarrjes së barabartë të personave me aftësi të kufizuara në jetën politike njihet si një nga parimet në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara², e cila kërkon që shtetet anëtare të punojnë ngushtë me dhe të përfshijnë në mënyrë aktive persona me aftësi të kufizuara, përfshirë përfaqësuesit e tyre dhe përfaqësuesit e organizatave të tyre joqeveritare, në politikëbërje dhe procese të tjera në shoqëri.

1 <https://bit.ly/3pxAX87>

2 Konventa e KB për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara: <https://bit.ly/2MzdgO6>

Një nga mënyrat e para dhe themelore të përfshirjes politike të personave me aftësi të kufizuara është përfshirja e tyre në procesin zgjedhor dhe ushtrimi i të drejtave themelore civile për të votuar dhe për t'u zgjedhur. Në këtë proces, si në shumë të tjerë, ekzistojnë një numër sfidash, por ka edhe mundësi për t'i tejkaluar ato.

Me pjesëmarrje më të madhe në proceset zgjedhore dhe politike, personat me aftësi të kufizuara do të forcojnë aktorët e tjerë politikë për t'iu përgjigjur më mirë dhe në mënyrë më efektive nevojave dhe problemeve të të gjithë qytetarëve.

2. PËR PROJEKTIN

Raporti mbi të drejtën e votës së personave me aftësi të kufizuara nga monitorimi i Zgjedhjeve parlamentare 2020 u përgatit nga Shoqata Inkluziva, me mbështetjen e Fondacionit Uestminster për Demokraci (FUD) nën Nismën për demokraci në Ballkanin Perëndimor, financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore. Në Maqedoninë e Veriut, FUD po zbaton projektin “Mbështetja e pjesëmarrjes politike të grupeve të marginalizuara dhe personave me aftësi të kufizuara”. Përmes këtij projekti, Shoqata Inkluziva organizoi monitorimin e parë të zgjedhjeve parlamentare dhe në kushtet e pandemisë globale - KOVID-19 nga personat me aftësi të kufizuara në korrik të vitit 2020. Përveç monitorimit të procesit të zgjedhjeve, Inkluziva gjithashtu monitoroi mbulimin e mediave në lidhje me aksesin dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor. Përmes këtij aktiviteti, FUD synon të mbështesë pjesëmarrjen politike dhe ushtrimin e së drejtës së votës së personave me aftësi të kufizuara, të rrisë dukshmërinë e kësaj çështje në publik dhe të kontribuojë në krijimin e rekomandimeve dhe politikave reale dhe përkatëse, në mënyrë që të përmirësojë pjesëmarrjen politike të personave me aftësi të kufizuara në procesin zgjedhor.

3. HISTORIKU

Sistemi demokratik në secilin shtet parashikon përpjekje dhe masa që u ofrojnë të gjithë qytetarëve kushte dhe mundësi për përfshirje të barabartë në jetën politike. Pas shpalljes së pavarësisë në vitin 1991, u mbajtën katër zgjedhje të rregullta dhe katër të parakohshme parlamentare në RMV. Zgjedhjet e fundit parlamentare u mbajtën në vitin 2016. Në përbërjen aktuale të Kuvendit shumëpartiak të Maqedonisë, nuk ka asnjë deputet të vetëm të zgjedhur me aftësi të kufizuara, gjë që tregon faktin se kjo e drejtë e garantuar e këtyre qytetarëve është e kufizuar.

E drejta e votimit dhe të drejtat politike të personave me aftësi të kufizuara përmenden në disa dokumente ndërkombëtare dhe në vend. Më 5 dhjetor 2011, RMV ratifikoi KDPA³, përfshirë edhe nenin 29 mbi pjesëmarrjen në jetën politike dhe publike. Që atëherë, vendi ynë ka marrë përsipër të zbatojë dispozitat e Konventës.

Në vitin 2016, Shoqata Inkluziva, përmes aktiviteteve kërkimore, identifikoi pengesat për pjesëmarrjen në jetën politike dhe elektorale të personave me aftësi të kufizuara. Ajo paraqiti përfundimet dhe rekomandimet nga kërkimi në Komisionin shtetëror të zgjedhjeve (KSHZ), një institucion për organizimin dhe kryerjen e proceseve zgjedhore, pas së cilës u krijua bashkëpunim dhe partneritet midis dy njëjësive. Me përpjekjet e përbashkëta të KSHZ dhe Inkluziva, janë futur burime shtesë për të mbështetur të gjithë votuesit, duke përfshirë votuesit me aftësi të kufizuara, të tilla si përdorimi i një modeli votimi për votuesit e verbër ose me shikim të kufizuar, kornizë të nënshkrimit dhe ilustrimet e procesit për te votuar.

3 Ligji për ratifikimin e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Protokollin opsional të Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Gazeta zyrtare, Nr. 172/2011, më 14 dhjetor 2011, në dispozicion në: <https://bit.ly/2YsL6af>

Në vitin 2018, Inkluziva për herë të parë u bë një organizatë e akredituar vëzhgimi me vëzhguesit e saj dhe monitoron vazhdimisht të gjitha proceset zgjedhore në vend për sa i përket aftësisë së kufizuar.

Për të marrë një pamje të besueshme të sfidave me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara për zgjedhjet e parakohshme parlamentare në vitin 2020 në kontekstin e pandemisë globale - KOVID-19, në drejtim të qasjes në burime, të drejta dhe shërbime për pjesëmarrje të barabartë në politike dhe procesin zgjedhor, si kandidatë, vëzhgues dhe votues, Inkluziva me vëzhguesit e saj me aftësi të kufizuara të akredituar monitoroi të gjithë procesin zgjedhor.

Rezultatet e monitorimit janë të një rëndësie të veçantë për nismat e ardhshme për ndryshime shoqërore, ndryshimet në politikat dhe programet, por edhe në krijimin e mjeteve për përcaktimin e avokimit dhe praktikave të veprimit në të ardhmen për të rritur të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

PËRCAKTIMI I ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE TË VITIT 2020

Zgjedhjet e vitit 2020 ishin planifikuar të mbaheshin rregullisht në dhjetor, por pasi vendet anëtare të BE-së nuk caktuan një datë për negociatat e aksesit të RMV, u mor një vendim për të mbajtur zgjedhjet e parakohshme parlamentare në 12 prill 2020.

Në periudhën para zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, RMV u prek nga pandemia KOVID-19, për shkak të së cilës procesi zgjedhor u ndërpre dhe më vonë u caktua një datë për zgjedhje më 15 korrik 2020.

Sipas⁴ Dekretit me fuqi ligjore të miratuar nga Qeveria e RMV, këto zgjedhje u votuan në një periudhë prej 3 ditësh, dmth më 13, 14 dhe 15 korrik. Në ditën e zgjedhjeve, 15 korrik, qendrat e votimit u hapën në orën 7:00 të mëngjesit dhe votimi zgjati deri në orën 21:00. Dita e zgjedhjeve, 15 Korriku, u shpall ditë jo pune dhe zgjedhjet u zhvilluan në përputhje me Rekomandimet e kujdesit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor gjatë procesit zgjedhor⁵, të miratuara nga KSHZ.

4 Dekreti me fuqi juridike i miratuar nga Qeveria e RMV: <https://vlada.mk/node/21766>

5 Rekomandime të detyrueshme për kujdesin shëndetësor gjatë procesit zgjedhor: <http://bit.ly/3r6hYC4>

I KORNIZA LIGJORE

Regjistrimi i fundit i popullsisë në RMV u krye në VITIN 2002 dhe për këtë arsye nuk ka statistika për personat me aftësi të kufizuara, i cili është një problem kryesor në avokimin e të drejtave të tyre.

Sipas Organizatës botërore të shëndetësisë (OBSh)⁶, 15% e popullsisë globale ka një lloj paaftësie. Në korrelacion me të dhënat nga 1 korriku 2020, kur KSHZ përfundoi listën e votuesve, lista përfundimtare përmbante 1,814,263 votues me të drejtë vote. Ky është një tregues i rëndësishëm që përafërsisht 272,139 qytetarë tanë me aftësi të kufizuara janë të penguar, të paaftë ose janë të privuar nga e drejta për të marrë pjesë në procesin zgjedhor, si votues, vëzhgues apo kandidat.

Neni 29 i KDPA, i nënshkruar nga RMV në vitin 2007 dhe i ratifikuar në vitin 2011, garanton të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për pjesëmarrje të barabartë në jetën publike dhe politike.

Nga viti 2016 e tutje, Shoqata Inkluziva ka bërë vazhdimisht rekomandime për harmonizimin e legjislacionit zgjedhor me dispozitat e Konventës për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, e cila në masë të madhe përputhet me rekomandimet e OSBE/ODIHR, por deri më tani është bërë shumë pak.

Kuadri ligjor për këto zgjedhje ka pësuar ndryshime që kanë prekur elementët kryesorë të procesit zgjedhor. Fatkeqësisht, propozimet nga Inkluziva që u dhanë dhe pranuan në grupin ndërinstitucional të punës për ndryshimin e Kodit zgjedhor (2018), nuk u morën parasysh.

Dispozitat kushtetuese dhe ligjore për heqjen e aftësisë juridike të personave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psikosociale, megjithëse janë në kundërshtim me dokumentet dhe standardet e nënshkruara ndërkombëtare,

⁶ <http://bit.ly/3r5BVZD>

mbetën të pandryshuara, të cilat përsëri u privuan këtyre personave të drejtën për të marrë pjesë në procesin zgjedhor. Me ndryshimet e fundit në Kodin zgjedhor, ishte e mundur që votuesit të cilët janë kujdesur në institucionet e kujdesit special për kujdesin jashtë-familjar në ditën e zgjedhjeve të votojnë në komunën ku po qëndrojnë, por kjo e drejtë u është mundur vetëm votuesve që qëndrojnë në shtëpitë e të moshuarve.

Në nenin 111 (Votimi i një personi të sëmurë dhe të ligë) të Kodit zgjedhor dhe në⁷ Udhëzimet për votimin e një personi të ligë dhe të sëmurë, personat që vazhdojnë të votojnë në këtë mënyrë trajtohen dhe regjistrohen si të sëmurë dhe të ligë, dhe jo si persona me aftësi të kufizuara dhe regjistrimi i votuesve që votojnë me mbështetjen e një personi tjetër vazhdoi të bëhej së bashku me votuesit jo-shkrim-lexues. Ky ishte procesi i parë zgjedhor i kryer gjatë pandemisë globale të shkaktuar nga koronavirusi i ri dhe sipas Rekomandimeve të kujdesit shëndetësor të detyrueshëm gjatë procesit zgjedhor.

Inkluziva ka zhvilluar një nismë me rekomandime për informimin dhe mbrojtjen e votuesve, vëzhguesve dhe anëtarëve të organeve zgjedhore me aftësi të kufizuara. Nisma iu dorëzua Komisionit për sëmundje infektive dhe KSHZ, por rekomandimet nuk u përfshinë plotësisht. Për të gjithë procesin e votimit dhe mbrojtjen nga KOVID-19, si dhe përdorimin e duhur të materialeve mbështetëse, Inkluziva ka përgatitur një Udhëzues audio për votimin për njerëzit që janë të verbër ose me të pamurit të dëmtuar⁸ të cilën KSHZ e miratoi në seancë të rregullt.

7 Udhëzues për votimin e një personi të ligë ose të sëmurë mund të gjeni në:
<http://bit.ly/2MbfK5A>

8 Udhëzues audio për votimin për njerëzit që janë të verbër ose me të pamurit të dëmtuar:
<http://bit.ly/3rbIR8R>

4. PËRMBLEDHJA E ANALIZËS SË VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE TË VITIT 2020

Shoqata “Inkluziva” organizoi vëzhgimin e zgjedhjeve parlamentare më 15 korrik 2020 nga vëzhguesit të cilët janë persona me aftësi të kufizuara. Ky është vëzhgimi i parë i zgjedhjeve parlamentare të zhvilluara në këtë mënyrë. Vëzhgimi u krye nga 67 vëzhgues me aftësi të kufizuara, të cilët monitoruan procesin e zgjedhjeve në 201 vendvotime në vend. Në prag të zgjedhjeve parlamentare, shoqata monitoroi gjithashtu mbulimin e 9 mediave televizive gjatë fushatave zgjedhore për të analizuar mbulimin e temave me interes për personat me aftësi të kufizuara.

Vendvotimet mbeten kryesisht të paarrtshme për qytetarët me aftësi të kufizuara. Ka shkallë para 76% të vendvotimeve dhe vetëm 45% prej tyre kanë rampa. Shumë nga rampat ekzistuese (42%) nuk janë të arritshme sepse nuk kanë gjerësinë ose pjerrësinë e kërkuar.

Hyrjet anësore në qendrat e votimit, të cilat mund të lehtësojnë hyrjen, shpesh nuk përdoren. Edhe pse 42% e vendvotimeve të monitoruara kishin hyrje të përbashkëta, vetëm 23% prej tyre ishin të hapura ditën e zgjedhjeve. Nga qendrat e votimit të vëzhguara, 82% ishin të vendosura në katin përdhes, por në 48% të objekteve kishte vendvotime në katin e parë, dhe vetëm në 2% të mjediseve kishte ashensor.

Në 86% të vendvotimeve, dyert janë mjaft të gjera që çdo votues të kalojë pa probleme, përfshirë edhe votuesit në karriget me rrota. Në 78% të vendvotimeve,

ka një hapësirë mjaft të gjerë për lëvizje të lehtë të votuesve me aftësi të kufizuara gjatë gjithë procedurës së votimit, dhe në 97% të vendotimeve ka dritë të mjaftueshme për të parë materialet dhe fletët e votimit qartë.

Gjatë zgjedhjeve, përdoren disa mjete për votim të arritshëm të personave me aftësi të kufizuara, dmth: paravanet në lartësi për persona në karrocë, një model votimi me shkronjë Braille dhe korniza për nënshkrim të lehtësuar. Sidoqoftë, megjithëse këto mjete janë futur në vitet e fundit, në një masë të madhe bordet zgjedhore nuk i përdorin ato si duhet ose aspak, duke i bërë ato të paarritshme për votuesit që kanë nevojë për to.

70% të vendotimeve të mbuluara kanë një kornizë për nënshkrim. Korniza mbështetëse në të ardhmen, në vend të materialit transparent, duhet të jetë prej materiali me ngjyra për të kryer më mirë funksionin e tij.

Shablloni i shkronjave Braille ishte i pranishëm në 71% të vendotimeve të vëzhguara, por në 47% të tyre modelet nuk u morën nga kutitë e materialeve të paraqitura dhe anëtarët e bordeve zgjedhore nuk ishin të njohur me qëllimin e tyre. Në dy qendra votimi, votuesit që përdorën modelin u përgjigjën se letra në Braille ishte e palexueshme.

Në të gjitha qendrat e votimit të vëzhguara, nuk ka paravan në lartësinë e një votuesi në një karrocë, por vetëm në 79% të tyre. Në 34% të vendotimeve, ato nuk ishin vendosur si duhet, dmth vendi ku ishte vendosur nuk mund të arrihej. Në 29% të vendotimeve të vëzhguara, nuk kishte asnjë kuti votimi të vendosur në lartësinë e një personi në karrocë.

Në 54% të vendotimeve, ishin regjistruar persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët 28% kishin mbështetjen e nevojshme, por 26% nuk ishin. Në 8% të vendotimeve, ishin regjistruar votuesit të cilët nuk mund të ushtronin të drejtën e tyre për të votuar për shkak të paarritshmërisë.

Gjatë monitorimit, vetëm 4 nga 9 stacione televizive kishin përmbajtje në çështjet që lidhen me personat me aftësi të kufizuara në lajmet e tyre. Nga shfaqjet e debatit të ndjekura, vetëm 2 shfaqje diskutuan të drejtat e këtij grupi.

Të dhënat e marra nga vëzhgimi i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vitin 2020 identifikuan shumë probleme, vështirësi dhe kufizime që parandalojnë personat me aftësi të kufizuara të marrin pjesë në procesin zgjedhor në mënyrë të barabartë me të tjerët. Zbatimi i zgjidhjeve sistemike për rritjen e pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara dhe sigurimi i së drejtës për të votuar duhet të jetë një nga përparësitë e institucioneve. Partitë politike duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të përfshirë personat me aftësi të kufizuara në punën e tyre dhe aksesin e tyre, veçanërisht në procesin zgjedhor. Media duhet të luajë një rol kryesor në sigurimin e një pranie më të madhe të temave dhe personave me aftësi të kufizuara në hapësirën mediatike dhe komunikimin e tyre të arritshëm, për të rritur rëndësinë e këtyre çështjeve në ligjërimin publik.

5. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

5.1. METODOLOGJIA

Nga 16 Shkurt 2020, kur Komisioni shtetëror i zgjedhjeve njoftoi për Zgjedhjet e parakohshme parlamentare në RMV, duke vendosur 12 prillin si datën fillestare për Zgjedhjet e parakohshme parlamentare 2020, Shoqata Inkluziva filloi me përgatitjen dhe zbatimin e Programit të vëzhgimit.


Përtë vëzhguar vendet e votimit në të gjashtë zonat elektorale, Shoqata Inkluziva shpalli një thirrje publike për regjistrimin e vëzhguesve me aftësi të kufizuara. Pas përpilimit të listës së personave që plotësuan kriteret e paracaktuara, Inkluziva filloi përgatitjet për zbatimin e trajnimeve për vëzhguesit.

Për shkak të pandemisë KOVID-19, trajnimet u shtynë sepse të gjitha aktivitetet zgjedhore u ndërprejnë dhe u miratuan masa për mbrojtjen dhe parandalimin e virusit KOVID-19, të cilat parandaluan dhe nuk u rekomanduan të organizonin ngjarje.


Pas 15 korrikut 2020 u caktua si datë për zgjedhjet, Inkluziva aplikoi në KSHZ për autorizim dhe akreditim të numrit më të madh të vëzhguesve deri më tani. Të gjithë vëzhguesit morën akreditim dhe vëzhgimi u krye nga 67 vëzhgues me aftësi të kufizuara.

Struktura socio-demografike e vëzhguesve me aftësi të kufizuara për këto zgjedhje ishte si më poshtë:


Grafiku 5.1.

Gjinia

Grafiku 5.2.

Paraprirësia

Grafiku 5.3.


Etnia

- ➔ Sipas gjinisë: 60% meshkuj dhe 40% femra;
- ➔ Sipas llojit të aftësisë së kufizuar, personat me aftësi të kufizuar fizike kanë dominuar me 63%, personat me aftësi të kufizuara në të pamurit me 15%, me aftësi të kufizuara të dëgjimit 19% dhe personat me aftësi të kufizuara intelektuale 3%;
- ➔ Sipas kombësisë, 85% ishin maqedonas, 9% shqiptarë, 4% serbë dhe romë 2%;

Tridhjetë persona me aftësi të kufizuara kishin përvojë vëzhgimi, ndërsa 37 vëzhguan procesin zgjedhor për herë të parë.

5.2. TRAJNIMI I VËZHguesve

Pas njoftimit të datës së zgjedhjeve, për sigurinë e shëndetit të pjesëmarrësve, trajnimet u kryen në internet për të cilat u bënë rregullimet e duhura.



Në trajnime, pjesëmarrësit u njohën me të gjitha procedurat, rregullat dhe metodat e vëzhgimit. Në përmbajtjen e trajnimeve, theks i veçantë u vu rekomandimeve dhe masave për mbrojtje nga KOVID-19. Me këtë përmbajtje, ata fituan aftësitë për të vlerësuar mundësinë e qasjes në qendrat e votimit dhe për të përshtatur siç duhet procesin zgjedhor për votuesit me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara.


5.3. PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Ekipi i projektit përpunoi të gjitha të dhënat e vëzhgimit duke përdorur softuer elektronik dhe tabelat Excel. Rezultatet e fituara u përdorën për përgatitjen e këtij dokumenti, nga i cili dolën nisma të reja që do t'u paraqiten autoriteteve zgjedhore, institucioneve, partive politike dhe aktorëve të tjerë të interesuar, në mënyrë që të kuptohet nevoja për të krijuar dhe organizuar procese politike dhe zgjedhore më përfshirëse në të ardhmen.

5.4. MBULIMI GJEOGRAFIK


Grafiku 5.4.

**Përfshirja e
vendvotimeve
sipas Njësive
zgjedhore**




Grafiku 5.5.

**Përfshirja e
komunave
sipas Njësive
zgjedhore**



Grafiku 5.6.

**Përfshirja e
vëzhguesve
sipas Njësive
zgjedhore**



Të tre grafikët tregojnë përqindjen: mbulimi i vendvotimeve, mbulimi i komunave dhe orari i vëzhguesve sipas zonave elektorale.

Vëzhgimi i vendvotimeve u zhvillua në të gjitha (gjashtë) zonat elektorale, në 28 komuna, në zonat urbane dhe rurale, në 201 vendvotime.

6. REZULTATET NGA VËZHGIMI I VOTIMIT

VOTIM PARA DITËS SË ZGJEDHJEVE

Numri i votuesve që votuan më 13 korrik

(personat që janë në karantinë për shkak të një testi pozitiv të KOVID-19 dhe personave të cilëve u është caktuar masa e vetë-izolimit)

723

Numri i votuesve që votuan më 14 korrik

(8,852 persona të sëmurë dhe të paaftë, 1,657 në burgje, 6 persona të zhvendosur brenda vendit dhe 357 votues në shtëpi pleqsh)

10.872


Për herë të parë, votimi në këto zgjedhje u zhvillua për një periudhë prej tre ditësh. Tabela e mësipërme tregon të dhënat nga 13 dhe 14 korrik 2020. Më 13 korrik, personat që janë në karantinë shtëpiake votuan për shkak të testit pozitiv të KOVID-19 dhe personat të cilëve u ishte caktuar një masë e vetë-izolimit me një vendim të Inspektoratit shtetëror sanitar dhe shëndetësor. Më 14 korrik, votuan personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurë, si dhe të sëmurët kronikë dhe persona të tjerë që, sipas Kodit zgjedhor, votojnë një ditë para zgjedhjeve. Në të njëjtën ditë, për herë të parë, personat që qëndronin në të gjitha shtëpitë e pleqve votuan, dhe disa nga njerëzit që qëndrojnë në këto shtëpi kanë një lloj paaftësie.

VOTIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Në ditën e zgjedhjeve, secili anëtar i BZ duhet të sigurojë që të gjitha aktivitetet e kryera në qendrën e votimit janë në përputhje me procedurat e përfshira në Manualin e edukimit. Për zgjedhjet e parakohshme parlamentare më 15 korrik 2020, BZ kishte detyrime të veçanta në përputhje me rekomandimet për KOVID-19.

Grafiku 6.1.

**A kishte në
vendvotim persona
tjerë me aftësi
të kufizuara?**



Lidhur me vëzhguesit e akredituar vendas, në këto zgjedhje u vu re se numri i vëzhguesve me aftësi të kufizuara është rritur në krahasim me zgjedhjet e mëparshme (Zgjedhjet presidenciale 2019). Nga 201 vendvotime të vëzhguara, 15% kishin vëzhgues të tjerë me aftësi të kufizuara, ndërsa në zgjedhjet e mëparshme kishte vetëm 4%. Ne besojmë se kjo përqindje është arritur për shkak të tërheqjes së punonjësve shëndetësorë të cilët janë anëtarë të BZ, dhe janë emëruar persona nga administrata ku ka nëpunës me aftësi të kufizuara.

Këto të dhëna tregojnë se personat me aftësi të kufizuara në kushte të tilla dëshirojnë dhe mund të jenë pjesë e të gjitha proceseve në vend, vetëm aftësitë dhe aftësitë e tyre duhet të njihen.

Shoqata Inkluziva monitoroi procesin zgjedhor me 67 vëzhgues me aftësi të kufizuara, ndërsa në pjesën tjetër të dokumentit rezultatet do të përmblihen sipas temave më të rëndësishme që dolën nga vëzhgimi.

A. QASSHMËRIA NË OBJEKTE DHE AMBIENTE

A.1. QASJA NË OBJEKTIN E VOTIMIT


Vendvotimet janë në pronësi të institucioneve shtetërore dhe qeverive lokale që kanë detyrimin të sigurojnë qasje në shërbimet publike për të gjithë qytetarët. Vendvotimet janë kryesisht të vendosura në shkolla ku arsimohen fëmijë dhe të rinj, përfshirë edhe ato me aftësi të kufizuara.

Në rast se nuk ka ndonjë objekt publik të disponueshëm për një qendër votimi në një vend të caktuar, KSHZ mund të marrë me qira një objekt privat. Në një rast të tillë, KSHZ duhet t'i përmbahet standardeve të aksesit dhe të zgjedhë një objekt privat të arritshëm.

Prandaj, në periudhën parazgjedhore, zyrat rajonale të KSHZ-së duhet të kryejnë vlerësime në secilin vendvotim nën juridiksionin e tyre dhe të marrin masat e duhura për të siguruar që të gjithë të përmbushin standardet e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose që përdoren vende alternative që plotësojnë standardet.


Grafiku 6.2.

**A kishte para
vendvotimit
vendparkim?**



Grafiku 6.3.


**A ka vendparkim
të shënuar për
persona me aftësi
të kufizuara?**



Për këto zgjedhje, KSHZ njoftoi se më shumë vendvotime do të zbresin në katin e parë, si pjesë e mbrojtjes nga KOVID-19, por që kjo do të sigurojë një qasje më të madhe fizike.


Grafiku 6.4.

**A kishte
shkallë për
qasje në
vendvotim?**




Grafiku 6.5.

**A kishte shkallë
para VV, a kishte
rampë?**



Grafiku 6.6.

**A ishin rampat
e qasshme?**



Sa i përket mundësisë së jashtme të qasjes në qendrat e votimit, u morën këto të dhëna: nga 201 vendvotime të monitoruara, kanë vendparkime përpara 70%, të cilat lehtësojnë shumë aksesin në vendvotimet për personat me aftësi të kufizuara. Sidoqoftë, shqetësues është fakti që nga parkingjet ekzistuese, vetëm 17% prej tyre kanë vend parkimi për personat me aftësi të kufizuara.


Nga 201 vendvotime, 76% qendra votimi kanë shkallë para tyre, nga të cilat vetëm 45% kanë rampa. Nga rampat ekzistuese, 42% nuk janë të arritshme sepse nuk kanë gjerësinë ose pjerrësinë e kërkuar. Analiza e të dhënave të mësipërme tregon se nga qendrat e votimit të monitoruara, mbi 70% nuk kanë qasje për personat me aftësi të kufizuara.

Vendvotimet e paarrtshme në Zonën elektorale 3

Kur këto të dhëna krahasohen me të dhënat nga vëzhgimi i Zgjedhjeve presidenciale në 2019, mund të shihet se nuk ka ndonjë përmirësim në zgjidhjen e këtij problemi.




Qasshmëria në hyrje në ambientet e votimit, sipas Njësive zgjedhore:



Grafiku 6.11.

Parkim në NJZ 5


- Po
- Jo
- Pa përgjigje



Grafiku 6.12.

Parkim në NJZ 6


- Po
- Jo
- Pa përgjigje



Grafiku 6.13.

Qasje në hyrje të vendvotimit (NJZ1)


- Po
- Jo
- Pa përgjigje



Grafiku 6.14.

Qasje në hyrje të vendvotimit (NJZ 2)


- Po
- Jo
- Pa përgjigje



Grafiku 6.15.

**Qasje në hyrje të
vendvotimit (NJZ 3)**


■ Po
■ Jo
■ Pa përgjigje



Grafiku 6.16.

**Qasje në hyrje të
vendvotimit (NJZ 4)**


■ Po
■ Jo
■ Pa përgjigje



Grafiku 6.17.

**Qasje në hyrje të
vendvotimit (NJZ 5)**


■ Po
■ Jo
■ Pa përgjigje



Grafiku 6.18.

**Qasje në
vendvotimin (NJZ 6)**


■ Po
■ Jo
■ Pa përgjigje



Meqenëse shumica e vendotimeve janë të vendosura në ndërtesa publike, ato kanë hyrje të ndara për shpërndarjen e ushqimit, materialeve dhe pajisjeve. Në shumicën e objekteve, këto hyrje anësore bëhen sipas standardeve të aksesit dhe mund të përdoren si një hyrje alternative për votuesit me aftësi të kufizuara.


Grafiku 6.19.

**A ka hyrje
dytësore?**




Grafiku 6.20.

**A është e hapur
hyrja dytësore?**



Grafiku 6.21.

**A kishte shenjë
për hyrjen
dytësore?**



42% të vendotimeve të monitoruara kishin hyrje të përbashkëta, por vetëm 23% e tyre ishin të hapura ditën e zgjedhjeve.

Kur hyrja alternative është e disponueshme, duhet të ketë udhëzime të qarta për gjetjen dhe përdorimin e kësaj hyrjeje, për këto zgjedhje vetëm 21% të vendotimeve ishin shënuar me hyrje alternative.

“Në qendrën e votimit 1530 ka një hyrje anësore që është e arritshme për personat me aftësi të kufizuara, por nuk ka asnjë shenjë për të dhe ajo ishte e mbyllur deri në pasdite.”⁹

A.2. QASJA NË QENDRËN E VOTIMIT

Për votuesit dhe vëzhguesit me aftësi të kufizuara (njerëz me vështirësi në lëvizje dhe njerëz të verbër ose me shikim të dëmtuar), si dhe për votuesit e moshuar, është me rëndësi të madhe nëse qendra e votimit është e arritshme në vendvotim.

Nga 201 vendvotime, 29% kanë shkallë në hyrje që është një problem i madh, përveç kësaj 31% e tyre kanë një jastëk dezinfektues sfungjer ngjitur me hyrjen përmes së cilës personat me aftësi të kufizuara nuk janë në gjendje të kalojnë.


“Në qendrën e votimit 2486, kishte një sfungjer për dezinfektimin e këpucëve përpara çdo dore, kështu që njerëzit me karroca dhe ndihmesa për lëvizje nuk mund të hynin për të votuar”.¹⁰

⁹ Vëzhgues nga Probishtipi (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)

¹⁰ Vëzhgues nga Shkupi (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)


Grafiku 6.22.

A ka shkallë (jo deri në katin e fundit) në hyrje të ndërtesës?




Grafiku 6.23.

A ishte vendvotimi në përdhësë?



Grafiku 6.24.


A ka ashensor në objektin?



Nga 201 vendvotime të vëzhguara nga personat me aftësi të kufizuara, 82% ishin të vendosura në katin përdhës, por në 48% të objekteve kishte dhoma në katin e parë, dhe vetëm në 2% të ambienteve kishte ashensor.


Grafiku 6.25.

A kishte në korridor gjëra të panevojshme?




Grafiku 6.26.

**A kishte
vendotimi
tualet në afërsi?**



Grafiku 6.27.

**A është tualeti
i arritshëm për
personat me aftësi
të kufizuara?**



Nga 201 vendvotime të monitoruara, 9% nga tyre kanë gjëra të panevojshme në korridoret për në qendrën e votimit, të cilat pengojnë lëvizjen e votuesve me aftësi të kufizuara, në 93% të tyre ka një tualet afër, por disa nga tualetet janë të mbyllura.

Problemi i madh është se vetëm 60% e tualeteve janë të arritshme për personat me aftësi të kufizuara, ka shkallë, pragje të larta për të hyrë në to, dhe brenda ka korridore dhe dyer të ngushta.

“Ashtë një tualet në qendrën e votimit 0727, por ishte i mbyllur gjatë gjithë kohës, ne dhe anëtarët e BZ kishim një problem të madh.”¹¹


¹¹ Vëzhgues nga Kërçova (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)

A.3. MBËSHTETJE NË QASJE NË QENDRËN E VOTIMIT

Ekzistojnë parregullsi dhe pengesa që ndikojnë që votuesi me aftësi të kufizuara të mos ushtrojë të drejtën e tij/saj për të votuar, edhe pse jashtë ose brenda vendvotimit ka kushte për votim të pandërprerë.


Grafiku 6.28.

A ofron BZ ndihmë personave me aftësi të kufizuara në qasjen në vendvotim?



Grafiku 6.29.

A u jepnin përparësi anëtarët e KZ votuesve me aftësi të kufizuara?



Për votuesit me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë në gjendje të hyjnë, dmth. të qasin në qendrën e votimit, bordi zgjedhor është i detyruar t'u mundësojë atyre që të hyjnë në qendrën e votimit në një mënyrë të përshtatshme për të ushtruar të drejtën e tyre për të votuar.

Nga 201 vendvotime të vëzhguara, në 54% të vendvotimeve janë regjistruar persona me aftësi të kufizuara, nga të cilët në 28% të vendvotimeve votuesve me aftësi të kufizuara u është dhënë mbështetja e nevojshme, kurse në 26% jo. Në 8% të vendvotimeve, ishin regjistruar votuesit të cilët nuk mund të ushtronin të drejtën e tyre për të votuar për shkak të paarritshmërisë.

Votuesit me vështirësi në lëvizje nuk mund të qëndrojnë gjatë dhe, nëse nuk u jepet përparësi, mund të heqin dorë nga e drejta e votës. Nga 201 vendvotime të vëzhguara, 60% e tyre kishin votues me vështirësi në lëvizje, nga të cilët 39%

u dha përparësi në ushtrimin e votimit, por në 21% jo. Komentet e vëzhguesve vunë re se disa anëtarë të bordit zgjedhor nuk dinin si t'i ndihmonin votuesit me aftësi të kufizuara, ndërsa të tjerët, për shkak të distancës fizike të detyrueshme, nuk dinin nëse u lejohej t'u afroheshin atyre për mbështetje.

"Gjatë vëzhgimit tim në qendrën e votimit 1539, kishte njerëz me aftësi të kufizuara që kishin nevojë për mbështetje, por anëtarët e BZ nuk ishin informuar nëse kishin të drejtë të ndihmonin votuesit dhe mbanin distancën e tyre në çdo kohë."¹²


A.4. QASJA NË DHOMËN E VOTIMIT

Salla e votimit është një element shumë i rëndësishëm në ushtrimin e së drejtës së votës. Në ditën e votimit, është me rëndësi të madhe nëse votuesit lejohen të kryejnë të gjitha procedurat në procesin e votimit pa probleme dhe të pavarur në procesin e votimit.

¹² Vëzhgues nga Probishtipi (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)


Grafiku 6.30.

**A është dera në
vendvotim mjaft
e gjerë satë hyjë
votues me karrocë?**




Grafiku 6.31.

**A ka vend për lëvizje
për votuesit me
aftësi të kufizuara
në vendvotim?**



Grafiku 6.32.

**A ka dritë të
mjaftueshme
në vendvotim?**



Nga 201 vendvotime, 86% kanë një derë mjaft të gjerë sa të kalojë çdo votues, përfshirë këtu edhe votuesit në karriget për invalidë. Në 78% të vendvotimeve ka një hapësirë mjaft të gjerë për lëvizje të lehtë të votuesve me aftësi të kufizuara gjatë gjithë procedurës së votimit, dhe në 97% të vendvotimeve ka dritë të mjaftueshme për të parë qartë materialet dhe fletët e votimit.


B. QASSHMËRIA NË PROCESIN E VOTIMIT

B.1. PROCESI I VOTIMIT

Në mënyrë që votuesit dhe vëzhguesit të jenë në gjendje të kryejnë të gjitha procedurat në procesin zgjedhor në një kohë dhe në mënyrë korrekte, qendra e votimit duhet të jetë e hapur në kohë, por gjithashtu të gjithë anëtarët e BZ (5 anëtarë) duhet të jenë të pranishëm. Vëzhguesit me aftësi të kufizuara vëzhguan tre qendra votimi, njëra prej të cilave ishte e hapur dhe e mbyllur. Nga 68% në të cilat morën pjesë vëzhguesit me aftësi të kufizuara para fillimit të votimit, 64% u përgjigjën se ishin të hapur në 06:30 (në kohën kur vëzhguesit ishin në hapjen e vendvotimeve) dhe 4% nuk ishin të hapur në kohë.


Grafiku 6.33.

**A u hap
vendvotimi
në kohë?**




Grafiku 6.34.

**A janë prezent
gjithë anëtarët
e BZ?**



Grafiku 6.35.

**A kishit
probleme
gjatë
legjitimitit?**



Nga 201 vendvotime, në 95% prej tyre ishin prezent të gjithë anëtarët e BZ.

Kur u pyetën nëse BZ-të identifikojnë saktë vëzhguesit me aftësi të kufizuara, në 9% të vendvotimeve vëzhguesit u përgjigjën se kanë probleme me identifikimin, sepse anëtarët e BZ-së u mohojnë të drejtat e tyre të vëzhgimit.

“Gjatë identifikimit tim në vendvotimin 2637, qëndrimi i anëtarëve të bordeve zgjedhore nuk ishte korrekt. Presidenti i BZ këmbënguli të ruajë autorizimin tim. U përpoqa t’i shpjegoja atij se më duhej autorizimi për të vëzhguar në qendrat e tjera të votimit, por ai nuk donte ta kuptonte. “Pasi u paraqita në INKLUZIVA, KSHZ reagoi dhe më vonë autorizimi im u kthye tek unë.”¹³

Në mënyrë që vëzhguesit dhe votuesit të jenë në gjendje të identifikojnë të gjithë anëtarët e BZ-së dhe të monitorojnë aktivitetet e tyre, ata duhet të janë të shënuar siç duhet. Për këtë proces zgjedhor, në 96% të vendvotimeve të vëzhguara BZ kishin karta identiteti.


Sekreti i së drejtës së votës është e garantuar ligjërisht për çdo votues. Lidhur me respektimin e sekretit të votimit, në 9% të totalit të vendvotimeve të vëzhguara, gjatë identifikimit të votuesve, anëtarët e BZ lexuan emrat e tyre me zë të lartë.

Në 31% të vendvotimeve kishte persona që nuk gjendeshin në listën e votuesve, dhe në 17% të tyre nuk u ishte shpjeguar se ku të shkonin. Gjithashtu, në 9% të vendvotimeve të vëzhguara, votuesit me aftësi të kufizuara nuk u gjetën në listën e votuesve.

13 Vëzhgues nga Shkupi (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)


Grafiku 6.36.

**A respektohet sekreti
i së drejtës së votës
gjatë identifikimit të
votuesve?**




Grafiku 6.37.

**A ka votues që
nuk janë në Listën
e votuesve?**



Grafiku 6.38.

**A keni vërejtur votues
me aftësi të kufizuara
që nuk gjenden në
listën e votuesve?**




Për votuesit me aftësi të kufizuara, ky është një problem i madh sepse shumë nga mjediset e KKZ-së nuk janë në dispozicion për tu kontrolluar nga votuesit dhe për këtë arsye këta votues shpesh heqin dorë nga procedurat e mëtejshme të votimit.

B.2. DISPONUESHMËRIA E MATERIALEVE TË VOTIMIT PËR MBËSHTETJE TË VOTUESVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Materialet ndihmëse për të gjithë votuesit, përfshirë votuesit me aftësi të kufizuara, u përgatitën dhe iu dorëzuan KKZ-ve në kohën e duhur.

Grafiku 6.39.

A ka kornizë për nënshkrim?



Korniza për nënshkrim është një mjet ndihmës që ndihmon votuesit të vendosin nënshkrimin e tyre në listën e votuesve. Ky mjet është i dobishëm për votuesit që janë të verbër ose me shikim të dobët, votuesit me aftësi të kufizuara të ekstremiteteve të sipërm dhe votuesit që kanë dridhje të duarve.

Me ndihmën e këtij mjeti, votuesit mund të nënshkruhen në vendin e duhur në listën e votuesve, duke zvogëluar kështu mundësinë e parregullsive në fletët e votimit. Përfshirë proceset e mëparshme zgjedhore rekomandohet që anëtarët e Bordit zgjedhor të përdorin dhe ofrojnë këtë mjet jo vetëm për personat me aftësi të kufizuara, por edhe për të gjithë votuesit e tjerë.

70% të vendvotimeve të mbuluara kishin një kornizë nënshkrimi, por vetëm 52% nuk e përdorën atë për të gjithë votuesit. Korniza për mbështetje gjatë nënshkrimit të listës së votuesve u ishte bërë nga material pa ngjyrë dhe kur u vendos në listën e votuesve, hapja për nënshkrim nuk mund të identifikohet.

“Në qendrën e votimit 2148, korniza dhe shablloni ishin në një kuti me materiale në një kënd. Me kërkesën time, një anëtar i BZ-së e shtoi atë afër listës së votuesve, por edhe më tutje nuk përdoreshte”.¹⁴

¹⁴ Vëzhgues nga Velesi (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)




Paravani i votimit është një hapësirë e mbyllur në qendrën e votimit e shënuar me një shenjë universale për aftësinë e kufizuar, ku votuesit me aftësi të kufizuara mund të votojnë në mënyrë të pavarur dhe të mbrojnë sekretin e votimit. Këto paravane të votimit për personat me aftësi të kufizuara duhet të jenë të qëndrueshme dhe stabile dhe nuk duhet të rrotullohen ose të lëvizin për të parandaluar aksidente ose incidente të tilla si rënie. Paraqitja e këtyre paravaneve nuk duhet të dallojë nga të tjerat.

Paravanet e votimit duhet të jenë me lartësi më të ulët në mënyrë që ato të vendosen në një bazë të fortë (për shembull, në një bankë). Me një dizajn të tillë, paravanet e votimit do të ishin të përshtatshme për votuesit që përdorin karriget për invalidë, votuesit që duhet të ulen, ato të verbrit, votuesit e moshuar dhe votuesit që përdorin ndihmesa për ecje, dhe pajisje tjera ndihmëse.


Grafiku 6.40.

A ka një paravan me lartësi të një personi në karrocë?




Grafiku 6.41.

A ka distancë midis paravaneve për tu mbajtur fshehtësia e votës?



Grafiku 6.42.

A janë kutitë e votimit në lartësinë e një votuesi në karrocë?



Nga 201 vendvotime, 79% prej tyre kishin një paravan në lartësinë e një votuesi në karrocë për invalidë, por 28% prej këtyre paravaneve nuk ishin të shpaktetuara (ishin në një zonë të largët). Në 34% të vendvotimeve, paravanet nuk ishin vendosur si duhet, dmth vendi ku ishte vendosur nuk mund të arrihej. Lidhur me stabilitetin e paravaneve, u konkludua se ato nuk janë aspak stabile, kur votuesit afrohen ata lëkunden dhe lëvizin.

“Në qendrën e votimit 1069, paravani për njerëzit me aftësi të kufizuara ishte mbështetur në një mur. BZ, në pyetjen time pse ishte kështu, u përgjigj se nuk kishte vend për të votuar votuesit e tjerë, e jo për personat me aftësi të kufizuara.”¹⁵

Për më tepër, pasi votuesi që ka përdorur një karrocë invalidash për të ketë votuar, në mënyrë që të jetë në gjendje të hedhë votën në mënyrë të pavarur në kutinë e votimit, ajo duhet të vendoset në një lartësi të përshtatshme. Në 29% të vendvotimeve të vëzhguara nuk kishte kuti votimi në lartësinë e një personi në karrocë.


Në këtë drejtim, nuk ka ndonjë përmirësim nga zgjedhjet e mëparshme, sepse për zgjedhjet presidenciale në vitin 2019, përqindja ishte identike me ato aktuale.

Ilustrimet e votimit janë një metodë shtesë e komunikimit me votuesit gjatë votimit dhe zvogëlojnë nevojën për shpjegime shtesë për të gjithë votuesit, përfshirë votuesit me aftësi të kufizuara intelektuale, votuesit e shurdhër dhe votuesit me pak ose aspak shkrim e lexim. Këto materiale lehtësojnë dhe përshpejtojnë procesin e votimit dhe ndihmojnë në parandalimin e reshteve të gjata në qendrat e votimit. Fotografitë e procesit të votimit për këto zgjedhje janë bërë në shtatë gjuhë. Përgatitja e tyre u organizua nga Inkluziva, ndërsa KSHZ i shpërndau ato në të gjitha qendrat e votimit. Nga 201 vendvotime, në 66% të tyre fotografitë janë vendosur në një vend të dukshëm, dhe në 34% të tyre nuk ka asnjë, me shpjegimin se nuk i kanë marrë nga KKZ-të.

15 Vëzhgues nga Kumanova (citim nga një raport nga monitorimi i zgjedhjeve parlamentare 2020)


Grafiku 6.43.

**A ka imazhe
sqaruese për
procesin e
votimit?**




Grafiku 6.44.

**A ka një
model
Braille?**



Grafiku 6.45.

**A ishte modeli
Braille i
vendosur në
tryezë?**



Modeli i votimit është një letre ose dosje plastike me simbole të prekshme në Braille në të cilën vendoset fleta e votimit. Duke përdorur modelin, një votues i verbër ose me shikim të dobët mund të shënojë fletëvotimin në mënyrë të pavarur. Pasi votuesi të ketë shënuar fletën e votimit duke përdorur modelin e votimit, ajo hiqet në mënyrë që fleta të duket e njëjtë me fletët e votimit për të cilat nuk është përdorur modeli i votimit.

Në këto zgjedhje, 71% të 201 vendvotimeve të vëzhguara kishin një model të tillë, por në 47% të këtyre vendvotimeve, modelet nuk u morën nga kutitë e materialeve të paraqitura, dhe anëtarët e bordeve të zgjedhjes nuk ishin në dijeni të qëllimit të tyre. Modeli i votimit për njerëzit që janë të verbër ose me pamje të dëmtuar për këto zgjedhje ishte bërë nga një material shumë i

hollë dhe mund të dëmtohej lehtë kur përdorej nga këta votues. Në dy qendra votimi, votuesit që përdorën modelin u përgjigjën se letra në Braille ishte e palexueshme.


B.3. NDIHMË DHE MBËSHTETJE GJATË VOTIMIT

